

Pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak dhe Të Prefekturës të sistemit të pikëzimit për programin e strehimit “Përmirësim I kushteve të banesave ekzistuese” , hapen aplikimet për programin e mësipërm.

, të cilat do të jenë në dy faza. E para realizohet përmes portalit qeveritar “eAlbania” brenda 30 ditëve kalendarike nga data 01.09.2025 deri me date 30.10.2025 dhe faza e dytë nga data 01.10.2025 deri me date 31.10.2025 për ato aplikantë që kanë kaluar me sukses fazën e parë . Në portal, qytetarët duhet të aplikojnë duke zgjedhur shërbimin “Kërkesë për të përfituar nga programet e strehimit social”.

Vetëm ata që kalojnë me sukses fazën e parë, duhet të depozitojnë pranë zyrave të Bashkisë Rrogozhinë , formularin e strehimit të plotësuar elektronikisht në portalin “e-Albania”. Kjo duhet të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike, shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar. Në lidhje me këto të fundit, të vlefshme do të konsiderohen dokumentet që janë lëshuar nga institucionet kompetente jo më herët se 3 muajt e fundit.

Individi/ familja që ka paraqitur të dhëna të pavërteta ose të pasakta, ose në kundërshtim me kushtet dhe kriteret e parashikuara në ligjin në fuqi për strehimin social dhe aktet nënligjore për zbatim të tij, i hiqet e drejta për të përfituar.

Ju faleminderit për mirëkuptimin ,Drejtoria e Mbrojtjes dhe Shërbimit Social!